

**KOSOVA GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE (1914-1918) –
ZONA OKUPUESE E AUSTRO-HUNGARISË**

REZYME E PUNIMIT MASTER

NGA

YLBERINA ALIU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

JANAR, 2024

KOSOVA GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE (1914-1918) – ZONA OKUPUESE E AUSTRO-HUNGARISË

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti

Kandidatja: Ylberina Aliu

Qëllimi i këtij punimi shkencor është që të dihet se çfarë ka ndodhur në Kosovë gjatë kohës kur ishte Lufta e parë Botërore në vitet 1914-1918, nga kush u pushtua gjatë kësaj kohe, si ishte gjendja e popullsisë në Kosovë. Studimi “Kosova gjatë Luftës së parë Botërore (1914-1918) – zona okupuese e Austro-Hungarisë”, ka për qëllim që përmes një objektive shkencore të shtjellojë një nga ngjarjet me shumë rëndësi për vendin tonë. Kosova gjatë Luftës së parë Botërore, ashtu si gjithë trevat e tjera shqiptare, u kthyen në arenë luftimesh, pushtimesh e ripushtimesh nga shtetet fqinje ballkanike dhe Fuqitë e Mëdha. Pushtimi i Kosovës nga Monarkitë serbo-malazeze u përcoll me qëndresë të armatosur nga shqiptarët. Ushtria serbe e malazeze, kreu vrasje e masakra ndaj popullsisë civile, dogji vendbanime të tëra dhe kreu dëbimin e popullsisë shqiptare nga trojet e veta.

Gjatë viteve 1913-1915, nën administrimin serbo-malazez në Kosovë u vendos një administratë kryesisht ushtarake, e cila qeveriste në mënyrë arbitrare; shqiptarët nuk iu nënshtruan pushtuesve të rinj dhe nuk u pajtuan me vendimet e konferencës së Ambasadorëve në Londër, prandaj gjatë viteve 1913-1915 organizuan kryengritje e aksione të armatosura, që kishin për qëllim çlirimin e Kosovës nga pushtimi e aneksimi serbo-malazez dhe bashkimin me shqipërinë. Padyshim, që në fillim të trajtimit të këtij punimi, i kam pasur parasysh vështirësitë që mund t'i kem gjatë hulumtimit dhe arritjeve të rezultateve konkrete mbi këtë temë. Nga fakti, që kjo temë duhet të trajtohet në mënyrë të saktë dhe hulumtuese, ishte dëshira dhe vullneti im që ta trajtojë këtë periudhë, që karakterizohet me një gjendje të rëndë për popullin e Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare. Trajtimi i temës “Kosova gjatë Luftës së parë Botërore 1914-1918 – zona okupuese e Austro-Hungarisë përbën një pjesë të rëndësishme të historisë së shqiptarëve të Kosovës. Trajtimi i kësaj teme bëhet me qëllim që të dimë sa më mire se çfarë ka ndodhur në Kosovë gjatë Luftës së Parë Botërore.

Që të jemi sa më të saktë në informatat që japim në këtë punim, kemi konsultuar literaturë të ndryshme duke filluar me autorë të huaj dhe vendorë.

Punimi është i ndërtuar në tre krerë kryesor të cilët janë të ndarë në nënkapituj të ndryshëm: Kreu i parë trajton pushtimin Austro-Hungarez dhe Bullgar, dhe do të ndahen në nënkapituj të ndryshëm që do t'i trajtojmë sipas ngjarjeve si p.sh zonat e pushtimit (1916-1918) sepse pushtimi i Kosovës dhe i trevave të tjera shqiptare nga Austro-Hungaria e Bullgaria u shoqërua me ndarjen e tyre, sipas konventës së 6 shtatorit 1915, në dy zona pushtimi, të cilat u krijuan përkatësisht në të majtë e në të djathtë të vijës Podujevë – Prishtinë – Lipjanë – Rahovec – Prizren; trajtohet marrëveshja Austro-Hungareze – Bullgare e 1 prillit 1916 që përcaktoi vijën përfundimtare midis dy zonave, gjithashtu trajtohet për gjendjen e popullsisë në Kosovë dhe në viset shqiptare lindore. Pastaj, në kreun e dytë trajtohet: “Qëndresa ndaj pushtuesve Bullgarë e Austro-Hungarezë (1916-1918)”. Në kreun e dytë është me rëndësi të trajtohet gjendja politike dhe ekonomike e popullsisë shqiptare në zonën bullgare dhe në zonën austro-hungareze, si dhe Qëndresa e armatosur e “kaçakëve”, në kushtet kur po rrezikohej edhe qenia e saj fizike, popullsia shqiptare në të dy zonat e pushtimit u detyrua të vetëmbrohej me të gjitha mënyrat e mundshme. Në kreun e tretë dhe të fundit të këtij punimi trajtohet Rivendosja e pushtetit civil dhe ushtarak serb në Kosovë, Kosova e viset e tjera shqiptare lindore u kthyen sërish në një trevë të ripushtuar. Pastaj në nënkapitujt, diskutohet për Masat për organizimin administrativ të viseve shqiptare (1918-1919), për fushatat e terrorit kundër shqiptarëve, si dhe për rregullimin tokësor-administrativ civil.

Në këtë studim për të arritur në një konkludim, do të përdoren metoda të ndryshme shkencore të studimit, siç është metoda e analizës, me anë të kësaj metode pasqyrojmë në mënyrë të përgjithshme gjendjen në atë kontekst kohor. Do të përdoren edhe metodat e tjera të kërkimit shkencor, sikurse: përshkrimi, hulumtimi dhe krahasimi. Pas përfundimit të studimit, në fund, në mënyrë të përgjithshme do të jepet edhe një përfundim në lidhje me këto ngjarje. Punimi mbyllet me literaturën e gjerë që e kemi shfrytëzuar. Gjatë punimit të diplomës kam shfrytëzuar literaturën adekuate për këtë temë, duke filluar me autorë vendorë dhe të huaj.